



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË  
TIRANË

Nr. 6153 Regj. Themeltar  
Datë 24.06.2014 e regjistrimit

Nr. Vendimi 4673  
Datë 11.09.2014



VENDIM



RR955399304AA

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane , e përberë nga:

**GJYQTARE GENTIANA MUCAJ**

me asistencen e sekretares gjyqësore **Eralda Skenderasi** , sot më datë 11.09.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative me Nr. 6153 Regj. Themeltar, që u përket palëve:

**PADITËS:** Qendra Respublica, perfaqesuar me ane te autorizimit date 24.07.2014 nga znj Albesa kurti ne mungese ,

**I PADITUR:** Ministria Mjesdisit , në mungesë,

**OBJEKTI:** Detyrimin e te paditurit te jape informacion dhe dokumenta zyrtare te kerkuara nga padittesi ne lidhje me :

- Sa eshte niveli I ndotjes ne Tirane gjate 24 oreve
- -Sa ehste niveli I ndotjes ne Tirane per cdo ore
- -Te na vihete ne dispozicion nje kopje e statistikave ne lidhje me nivelin endotje sne Shqiperi per gjahste mujorin e pare te vitit 2013.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23 I Kushtetutes se RSH, neni 10 I Konventes Eurorpiane te te Drejtave te Njerout, nenet 9/1 10 13/1 14, 18/b 20 45/1 51 55 118 e vijues te

k.pr.administrative nenet 37 te ligjit nr 8503 date 30.06.1999 "per te drejten e informimit pjesemarrje ne vendimamarrje dhe te drejten per tju drejtuar gjykates per ceshtje qe lidhen me mjedisin, neni 31 32/a te k.pr.civile nenet 15/a 17/1/c /f 40/1/c/f te ligjit nr 49/2012 date 03.05.2012 "per organzimin dhe funksionimin e Gjykates Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative

Gjykata konstatoi se ceshtja është në juridiksionin gjyqësor dhe në kompetencë të kësaj gjykate, dhe, pasi shqyrtoi provat dhe e bisedoi ceshtjen në tërësi,

### VËREN:.

Pala paditëse është person juridik i regjistruar pranë Gjykatës se rrethit gjyqsor Tiranë me Vendimin Nr.604 datë 13.04.2010, me Nr. L01704451 G, me objekt veprimtarie të kontribojë në edukimin dhe sensibilizmin e publikut për probleme akute sociale nëpërmjet publikimeve, ndërregjësimit në mediane dhe shkruar dhe televizione duke i kushtuar vëmendje të vecantë problemeve të kategorive të pambrojtura etj.

Perfaqesuesja e pales paditese ne baze te nenit 199 te kpr.civile kerkoj kalimin procedural nga Ministria e Mjedisit pyjeve dhe menaxhimit te Ujarave ne Ministria e Mjedisit.Gjykata bazuar ne nenin 199 te k.pr.civile vendosi te pranoje kerkesen e pales paditese per kalimin procedural vazhduar gjykimin me pale te paditur Ministria e Mjedisit.

Pala paditëse me anë të një Shkrese date 31.07.2013 i ka kërkuar Ministrisë se Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave sot Ministria e Mjedisit informacion në lidhje me :

- Sa është niveli i ndotjes në Tiranë gjatë 24 orëve
- -Sa është niveli i ndotjes në Tiranë për çdo orë
- -Te na vihet në dispozicion një kopje e statistikave në lidhje me nivelin e ndotjes në Shqipëri për gjatë muajit të parë të vitit 2013.

Pala e paditur nuk i ka kthyer përgjigje palës paditëse për një kohë të gjatë. Pala paditëse pasi ka pritur për një kohë të gjatë përgjigje nga Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave sot Ministria e Mjedisit i është drejtuar gjykatës me padi gjyqësore për të detyruar palën e paditur për dhënie informacioni.

Pala paditëse ka pretenduar se pala e paditur nuk ka respektuar ligjin për dhënie informacioni pa asnjë shkak të ligjshëm. Pala paditëse ka kërkuar. Cdo individ apo person juridik ka të drejtë të informohet për aktivitetin e institucioneve shtetëore. Asnjë institucion shtetëror nuk mund të refuzojë të japë informacion përvec rasteve të informacioneve të klasifikuara. Cënimi i kësaj të drejte është një dëmtrim i rëndë i besimit publik mbi institucionet.

Pala e paditur Ministria e Mjedisit ndonësë është lajmëruar rregullisht nga gjykata me anë të fletëthirrjes, nuk ka marrë pjesë në asnjë seancë gjyqësore. Në këto kushte gjykata me kërkesë të palës paditëse mbështetur në nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile ka vijaur në gjykimin në mungesë të palës së paditur.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, parashikon se:

*“Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.*

Ky parashikim kushtetues është në të njëjtën linjë me neni 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore:

*“Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e cdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar”*

Ndërkohë, gjykatat detyrohen edhe nga neni 44 i Kushtetutës, sipas të cilit:

*“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.*

Në nenin 3 të Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” parashikohet se

E drejta e informimit

*Çdo person ka të drejte të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qene i detyruar të shpjegoje motivet.*

k.pr.administrative nenet 3 7 te ligjit nr 8503 date 30.06.1999 "per te drejten e informimit pjesemarrje ne vendimamarrje dhe te drejten per tju drejtuar gjykates per ceshtje qe lidhen me mjedisin, neni 31 32/a te k.pr.civile nenet 15/a 17/1/c /f 40/1/c/f te ligjit nr 49/2012 date 03.05.2012 "per organzimin dhe funksionimin e Gjykates Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative

Gjykata konstatoi se ceshtja është në juridiksionin gjyqësor dhe në kompetencë të kësaj gjykate, dhe, pasi shqyrtoi provat dhe e bisedoi ceshtjen në tërësi,

### VËREN:.

Pala paditëse është person juridik i regjistruar pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr.604 datë 13.04.2010, me Nr. L01704451 G, me objekt veprimtarie të kontribojë në edukimin dhe sensibilizimin e publikut për probleme akute sociale nëpërmjet publikimeve, ndërngjegjësimit në median e shkruar dhe televizive duke i kushtuar vëmëndje të vecantë problemeve të kategorive të pambrojtura etj.

Perfaqesuesja e pales paditese ne baze te nenit 199 te kpr.civile kerkoj kalimin procedural nga Ministria e Mjedisit pyjeve dhe menaxhimit te Ujarave ne Ministria e Mjedisit.Gjykata bazuar ne nenin 199 te k.pr.civile vendosi te pranoje kerkesen e pales paditese per kalimin procedural vazhduar gjykimin me pale te paditur Ministria e Mjedisit.

Pala paditëse me anë të një Shkrese date 31.07.2013 i ka kërkuar Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave sot Ministria e Mjedisit informacion në lidhje me :

- Sa është niveli I ndotjes në Tiranë gjatë 24 orëve
- -Sa është niveli I ndotjes në Tiranë për çdo orë
- -Te na vihet në dispozicion një kopje e statistikave në lidhje me nivelin e ndotjes së Shqipërisë për gjatë muajit të parë të vitit 2013.

Pala e paditur nuk i ka kthyer përgjigje palës paditëse për një kohë të gjatë. Pala paditëse pasi ka pritur për një kohë të gjatë përgjigje nga Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave sot Ministria e Mjedisit i është drejtuar gjykatës me padi gjyqësore për të detyruar palën e paditur për dhënien e informacionit.